



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, _____.____.2026

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 06.07.2026

Drejtuar: BOE O.E.S DISTRIMED SHPK me 50% me NIPT K31520054N dhe EUROMED SHPK me 50% me NIPT K71718012P.

Adresa: Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, Pranë Marternitetit të ri.

Operatorit Ekonomik (OE) ☐ _____ ose

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: PROCEDURËN ME NEGOCIM, PA SHPALLJE PARAPRAKE
TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Objekti i procedurës së prokurimit: “Blerje materiale konsumi mjekësore, e ndarë në 2 (dy) lote, me afat 90 ditë, me kusht ndërprerjen e kontratës pa pasojë për AK, me administrimin e MK së lidhur nga MSHMS nga procedura konkurruese”, e ndarë në dy lote, ku: Lot 1- Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore dhe Lot 2- Materiale mjekimi konsumi kirurgjikale për nevoja spitalore”, **REF-90611-06-19-2026**.

Lot 2- “Materiale mjekimi konsumi kirurgjikale për nevoja spitalore” me FL: 49,397,740.20 (dyzet e nëntë milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet pikë dy) Lekë pa TVSH.

REF-90667-06-19-2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: (kjo procedurë nuk publikohet pasi procedura e prokurimit e perzgjedhur është negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës) Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike [Data] [Numri] (kjo procedurë nuk publikohet pasi procedura e prokurimit e perzgjedhur është negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës)

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE O.E.S DISTRIMED SHPK me 50% me NIPT K31520054N dhe EUROMED SHPK me 50% me NIPT K71718012P.

Ofertuar me vlerë: 46,812, 140 (Dyzet e gjashtë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet) lekë pa tvsh.

2. BOE “SOLED” shpk me 39.31 % me NIPT M42026032D dhe “ALBADENT GROUP” shpk me 60.69%, me NIPT L62217032L

Ofertuar me vlerë: 44, 900, 000 (Dyzet e katër milionë e nëntëqind mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Etj. _____

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

BOE “SOLED” shpk me 39.31 % me NIPT M42026032D dhe “ALBADENT GROUP” shpk me 60.69%, me NIPT L62217032L

Arsyet e skualifikimit:

Nga verifikimi i katalogëve/skedave teknike të paraqitura nga BOE “SOLED” shpk me NUIS M42026032D dhe “ALBADENT GROUP” shpk me NUIS L62217032L, rezulton si vijon:

1. Për zërin nr. 57 – “Beze kirurgjikale aktive”

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar artikullin:

Emërtimi i produktit: Beze kirurgjikale aktive
Specifikimet teknike: 7.5 cm x 7.5 cm, copë e thurur, me thithje të shpejtë për plagë, me përbërës polyakrylate (SAP), me veshje celuloze dhe solucion Ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent.

Nga verifikimi i katalogut të paraqitur rezulton se Operatori Ekonomik ka ofertuar produkt me përmasë **10 cm x 10 cm**. Ky ndryshim rezulton i pasqyruar edhe në ofertën teknike të paraqitur nga operatori ekonomik.

Ndërkohë, në shtojcën e listës së çmimeve, OE ka ofertuar produktin me përmasën **7.5 cm x 7.5 cm**, sikurse është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Për sa më sipër, konstatohet mospërputhje ndërmjet katalogut/skedës teknike dhe ofertës/listës së çmimeve të paraqitur nga OE, pasi në katalog produkti rezulton me përmasë 10 cm x 10 cm, ndërsa në listën e çmimeve është deklaruar me përmasë 7.5 cm x 7.5 cm.

Gjithashtu, dokumentacioni/komunikimi me email i paraqitur nga OE nuk provon në mënyrë të plotë barazvlefshmërinë teknike të produktit me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Dokumentacioni teknik duhet të krijojë lidhje të qartë ndërmjet katalogut, produktit të ofertuar, prodhuesit dhe certifikimit përkatës CE.

Në këto kushte, për këtë artikull rezulton se dokumentacioni i paraqitur nuk provon në mënyrë të plotë përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara në DST.

2. Për Artikujt 103–107, 125–137, 141–145: Kërkojnë provë të posaçme katalogu/CE për material, USP, gjatësi, tip/dimension age; dokumentacioni i lexuar nuk i lidh plotësisht të gjithë zërat. Nuk evidentohen plotësisht të dhënat e kërkuara.

3. Për zërin nr. 59 – “Beze hidroxhel”

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar artikullin me specifikimet teknike:

Beze e sfungjertë hidropolimere, hidroxheli me përbërje poliure/poliuretan-poliuretan polimer, propilen glikol, me buzë adezive poliakrilat. Përmasa 15 cm x 15 cm.

Nga verifikimi i katalogut të paraqitur nga Operatori Ekonomik rezulton se produkti është përshkruar si **hydrogel foam dressing**. Në dokumentacion përmendet shtresë hidroxheli, shkumë absorbente dhe film poliuretani, si dhe referohet përbërja me propilen glikol dhe buzë adezive poliakrilat.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar specifikisht që produkti të ketë përbërje me **poliure/poliuretan-poliuretan polimer dhe propilen glikol**, ndërsa në katalogun e paraqitur nga OE nuk evidentohet në mënyrë të plotë dhe të qartë përbërja kimike sipas specifikimit të kërkuar nga AK. Për rrjedhojë, për këtë artikull rezulton se dokumentacioni teknik i paraqitur nuk provon në mënyrë të plotë përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

4. Artikujt 35–40 – Shiringa: Nuk provohen plotësisht për shkak të nevojës për lidhje të qartë kod-katalog-CE dhe zinxhirit prodhues dhe distributor dhe Albadent.

Sa më sipër, KVO vlerëson se , BOE SOLED shpk dhe ALBDENT GROUP SHPK shpk nuk plotësojnë kriterin e përcaktuar në DST.

II. Lidhur me kriterin për dëshmi për furnizime të ngjashme

“2.3. Kapaciteti teknik: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë”:

Nga verifikimi i faturave të paraqitura nga Operatori Ekonomik Soled SHpk rezulton se OE nuk provon furnizime për zëra të njëjtë ose të ngjashëm me të gjithë artikujt e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nga faturat e administruara rezulton se një pjesë e konsiderueshme e artikujve të cituar në fatura nuk përputhet me objektin dhe artikujt konkretë të kërkuar nga AK, ndërkohë që shumë prej zërave të kërkuar në procedurë nuk rezultojnë të provuar në dokumentacionin e dorëzuar.

Për rrjedhojë, Operatori Ekonomik **“SOLED” SHPK**, në faturat e ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik, nuk ka provuar mjaftueshëm zëra të ngjashëm në natyrë dhe metodologji me zërat e furnizimit objekt prokurimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga Operatori Ekonomik **“SOLED” SHPK**, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur fatura tatimore, nëpërmjet të cilave vërteton se, ndër të tjera, ka kryer furnizime me artikuj që lidhen me objektin e prokurimit. Megjithatë, KVO, pasi veçoi vetëm zërat e mallrave që mund të konsiderohen realisht të ngjashëm me objektin e prokurimit, vëren se nga përllogaritja e këtyre zërave në faturat e paraqitura nuk përmbushet vlera e kërkuar për kontrata/furnizime të ngjashme.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të provojë kontrata/furnizime të ngjashme në vlerë jo më pak se 39% e fondit limit, i cili është 49,397,740.20 lekë pa TVSH (dyzet e nëntë milionë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet lekë e njëzet qindarka pa TVSH). Për rrjedhojë, vlera minimale që duhet të provohej është 19,265,118.68 lekë pa TVSH (nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë lekë e gjashtëdhjetë e tetë qindarka pa TVSH).

BOE nuk provon arritjen e pragut minimal të kërkuar për kontrata/furnizime të ngjashme, pasi vlera e dokumentuar, vetëm për zërat që konsiderohen realisht të ngjashëm me objektin e prokurimit, është më e ulët se vlera minimale e kërkuar në DST.

Në këto kushte, KVO gjykon se faturat e paraqitura në SPE nuk përmbajnë mjaftueshëm zëra të ngjashëm në natyrë dhe metodologji me zërat objekt furnizimi/prokurimi, dhe për rrjedhojë nuk provohet përmbushja e kriterit të kontratave/furnizimeve të ngjashme.

Ky vlerësim mbështetet edhe në qëndrimin e mbajtur në **Vendimin e KPP nr. 1441/2024**, sipas të cilit, për efekt të përmbushjes së kriterit të eksperiencës së ngjashme, duhet të merren në konsideratë vetëm ato furnizime që janë realisht të ngjashme me objektin e prokurimit në natyrë, karakteristika dhe metodologji realizimi, dhe jo çdo zë i faturuar në mënyrë të përgjithshme.

III. Lidhur me kriterin për paraqitjen e bilanceve vjetore sipas DST kriteri 2.2. pika 2:

Në Dokumentet Standarde të Tenderit, në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar, është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë bilancet vjetore për vitet ushtrimore të kërkuara, sipas përcaktimeve në DST. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton se Operatori Ekonomik ALBDENT GROUP SHPK ka paraqitur bilancet vjetore për vitet **2023, 2024 dhe 2025**. Megjithatë, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se bilancet e kësaj shoqërie nuk janë shoqëruar me raport auditimi ligjor, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, konkretisht referuar nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, **“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”**, i ndryshuar, sipas të cilit pasqyrat financiare vjetore, kur plotësohen kushtet ligjore, duhet të shoqërohen edhe me raportin e auditimit ligjor, të kryer nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Në këto kushte, KVO vlerëson se dokumentacioni financiar i paraqitur nga **ALBDENT SHPK** nuk provon në mënyrë të plotë përmbushjen e kriterit të kërkuar në DST, pasi bilancet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me raportet përkatëse të auditimit ligjor.

Sa i përket Operatorit Ekonomik **SOLED SHPK**, nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se ky operator ka paraqitur vetëm bilancin e vitit **2025**, ndërkohë që në DST është kërkuar paraqitja e bilanceve për tre vitet ushtrimore të përcaktuara. Për rrjedhojë, KVO vlerëson se **SOLED SHPK** nuk përmbush kriterin e paraqitjes së bilanceve për tre vitet e kërkuara në DST. Mungesa e bilanceve për vitet e kërkuara sjell edhe pamundësinë e KVO-së për të verifikuar dhe zbatuar kushtin e përcaktuar në DST, sipas të cilit: **“Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”**

Referuar sa më sipër, KVO vlerëson se BOE **SOLED SHPK & ALBDENT GROUP SHPK** nuk provon përmbushjen e kriterit të kapacitetit ekonomik dhe financiar lidhur me paraqitjen e bilanceve vjetore, sipas kërkesave të përcaktuara në DST.

IV. Lidhur me kriterin 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 4

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, për Operatorin Ekonomik **ALBDENT GROUP SHPK** është identifikuar autorizimi i lëshuar nga **CFO Pharma** për produktet **SERIX/Changzhou**, me vlefshmëri deri më **25.06.2028**.

Ky dokument vlerësohet në funksion të përmbushjes së kriterit për autorizimin nga prodhuesi/distributori i autorizuar, pasi lidhet me lejimin e tregtimit të produkteve përkatëse dhe dokumentimin e marrëdhënies tregtare/distributive për artikujt e ofertuar.

Megjithatë, ky dokument nuk mund të konsiderohet dhe nuk zëvendëson licencën/autorizimin përkatës të lëshuar nga **MSHMS**, në rast se një dokument i tillë është kërkuar si kriter i veçantë në DST.

Nëse në SPE është paraqitur akt i lëshuar nga **MSHMS** për **ALBDENT GROUP SHPK**, i vitit **2024**, ai duhet të vlerësohet në mënyrë të veçantë dhe të pavarur nga autorizimi prodhues/distributor. Për këtë akt duhet të verifikohet individualisht numri i dokumentit, objekti i veprimtarisë që mbulon, afati i vlefshmërisë, si dhe çdo akt shtyrjeje apo dokument që provon vlefshmërinë aktive të tij në momentin e dorëzimit të ofertës.

Për rrjedhojë, autorizimi **CFO Pharma – SERIX/Changzhou**, i vlefshëm deri më **25.06.2028**, mund të merret në konsideratë vetëm për kriterin e autorizimit prodhues/distributor, ndërsa kriteri lidhur me licencën apo aktin e MSHMS duhet të shqyrtohet dhe vlerësohet veçmas, sipas kërkesave konkrete të përcaktuara në DST”.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE O.E.S DISTRIMED shpk me NUIS K31520054N dhe EUROMED shpk me NUIS K71718012P, me adresë: Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, Pranë Marternitetit të ri, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej ofertë e paraqitur me vlerë: 46,812, 140 (Dyzet e gjashtë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet) lekë pa tvsh, pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, **brenda 1 dite** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR